FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 82	2002	Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8977 datë 12.12.2002	Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë……	2345
Ligj nr. 8978 datë 12.12.2002	Për taksën vendore për biznesin e vogël…….	2363
Ligj nr. 8979 datë 12.12.2002	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshimet përkatëse…….	2369
Ligj nr. 8980 datë 12.12.2002	Për disa ndryshime në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”……	2373
Ligj nr. 8981 datë 12.12.2002	Për miratimin e niveleve të tarifës doganore……..	2375
Ligj nr. 8982 datë 12.12.2002	Për sistemin e taksave vendore……..	2376

L I G J
Nr. 8977, datë 12.12.2002

PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton llojet e taksave kombëtare që zbatohen në Republikën e Shqipërisë, nivelin e taksave, procedurat e llogaritjes, arkëtimit dhe transferimit në Buxhetin e Shtetit, si dhe detyrimet që kanë agjentët e taksave kombëtare.

Neni 2

Në Republikën e Shqipërisë, sistemi i taksave përbëhet nga taksat kombëtare dhe taksat vendore. Ky ligj trajton taksat kombëtare. Taksat vendore trajtohen me ligj të veçantë.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllime të këtij ligji, fjalët e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. "Taksapagues" është çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i cili është i detyruar të paguajë një nga taksat kombëtare, të përcaktuara në këtë ligj.
2. "Taksë" janë taksat kombëtare, të vendosura me këtë ligj.
3. "Agjent i taksave" është personi, i cili, sipas kërkesave të këtij ligji, është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e Buxhetit të Shtetit të të ardhurave nga taksat kombëtare.

Neni 4
Llojet e taksave kombëtare

Taksat kombëtare janë:

1. Taksat portuale.
2. Taksat për shërbimet konsullore.
3. Taksa vjetore e tonazhit të mjeteve për aks.
4. Taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja.
5. Taksa e importimit të automjeteve të përdorura.
6. Taksa e pajisjes me lejedrejtimi për drejtim automjeti.
7. Taksa e përdorimit të aparateve radiotelevizive.
8. Taksa e përdorimit të numrit telefonik.
9. Taksa për veprime e shërbime nga administrata gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria, noteria dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
10. Taksa e regjistrimit në arsimin e lartë.
11. Taksa për shërbimet e radiokomunikacioneve.
12. Taksa vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive.
13. Taksa e kalimit me avion të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë.
14. Taksa e pajisjes së personave me pasaportë lundrimi.

15. Taksa për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit.
16. Taksa e akteve dhe e pullës.
17. Taksa për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport.
18. Taksa për mbikalimet ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë.
19. Taksa e rentës minerare.
20. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e luajtshme (automjetet).
21. Taksa e rrugës Durrës-Kukës:
a) mbitaksa për importet e taksueshme;
b) taksa për konsumin e karburanteve;
c) taksa vjetore nga tatimpaguesit e regjistruar në TVSH.
22. Taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin.
23. Taksa për ambalazhet plastike të lëngjeve (bidona, shishe plastike e kuti të plastifikuara të të gjitha formave dhe përmasave), të mbushura, të prodhuara në vend dhe të importuara, për produktet: ujë, pije freskuese, lëngje frutash e perimesh, qumësht dhe nënproduktet e tij, vajra ushqimore, vajra lubrifikante dhe detergjentë.

Neni 5
Niveli i taksave kombëtare

Niveli i taksave kombëtare të përmendura në nenin 4 është:
1. Taksat portuale paguhen nga anijet, të cilat kryejnë veprimtari tregtare, sa herë që prekin portet dhe radat e Republikës së Shqipërisë, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji, dhe që është pjesë përbërëse e tij.
Veprim tregtar i anijes quhet ngarkimi ose shkarkimi i mallrave, zbarkimi dhe imbarkimi i udhëtarëve për transport.
Nuk quhen veprime tregtare:
a) riparimi ose dokimi i anijeve;
b) zbarkimi i personave të transportuar nga anija, të cilët ndiqen nga autoritetet përkatëse ligjore;
c) zbarkimi ose imbarkimi i pjesëtarëve të ekuipazhit të anijeve dhe të personave të sëmurë dhe të vdekur;
ç) ngarkimi ose shkarkimi i mallrave të përfaqësive të trupit diplomatik të akredituar në Republikën e Shqipërisë dhe të përfaqësive tona diplomatike jashtë vendit;
d) furnizimi i anijeve me ujë të pijshëm, sende ushqimore, karburante e lubrifikante, materiale e pjesë ndërrimi etj.;
dh) ndalesat në porte të anijeve për shkak të kohës së keqe, avarive të ndryshme dhe veprimeve në ndihmë të tyre nga anijet e tjera;
e) hyrja në porte pa ngarkesë e anijeve të personave fizikë e juridikë, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.
2. Taksat për shërbimet konsullore caktohen sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Taksa vjetore e tonazhit të mjeteve për aks caktohet sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja caktohet sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Taksa e importimit të automjeteve të përdorura caktohet:
5.1. Për mjetet e prodhuara deri më 31 dhjetor 1995:
a) për autoveturat: 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë;

b) për mjetet e tjera për transportin e jo më shumë se 10 personave, mikrobusë, furgonë dhe mjete të tjera për transportimin e mallrave me peshëmbajtje deri në 5 tonë: 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë;
c) për autobusët dhe mjetet e tjera për transportin e mallrave me peshëmbajtje mbi 5 tonë: 100 000 (njëqind mijë) lekë;
ç) për traktorët rrugorë (kokat tërheqëse) 40 000 (dyzetë mijë) lekë.

5.2. Për mjetet e prodhuara nga data 1 janar 1996:

a) për autoveturat: 40 000 (dyzet mijë) lekë;

b) për mjetet e tjera për transportin e jo më shumë se 10 personave, mikrobusë, furgonë dhe mjete të tjera për transportimin e mallrave me peshëmbajtje deri në 5 tonë:

50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

c) për autobusët dhe mjetet e tjera për transportin e mallrave, me peshëmbajtje mbi 5 tonë: 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

ç) për traktorët rrugorë (kokat tërheqëse) 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

6. Taksat e pajisjes me leje drejtimi për drejtimin e automjeteve caktohen:

a) për lejedrejtimi të kategorisë A 3 000 (tre mijë) lekë;

b) për lejedrejtimi të kategorisë B 4 500 (katërmijë e pesëqind) lekë;

c) për lejedrejtimi të kategorisë C 2 000 (dy mijë) lekë;

ç) për lejedrejtimi të kategorisë D 3 000 (tre mijë) lekë;

d) për lejedrejtimi të kategorive

BE, CE dhe DE 3 000 (tre mijë) lekë.

7. Taksa e përdorimit të aparaturave radiotelevizive nga çdo përdorues caktohet:

a) për marrësit radiofonikë 100 (njëqind) lekë në vit;

b) për marrësit televizivë 400 (katërqind) lekë në vit.

Kjo taksë llogaritet dhe paguhet nga përdoruesit familjarë vetëm për një marrës radioteleviziv, pavarësisht nga numri i aparateve që kanë në familje. Për përdoruesit e tjerë jo familjarë kjo taksë paguhet për çdo aparat marrës.

8. Taksa për përdorimin e numrit telefonik:

a) për telefoninë kabllore paguhet nga çdo zotërues në masën 200 (dyqind) lekë në vit;

b) për telefoninë celulare me kontratë paguhet nga çdo zotërues në masën 400 (katërqind) lekë në vit;

c) për telefoninë celulare me parapagim (kartë) paguhet nga çdo zotërues në masën 700 (shtatëqind) lekë, vetëm në çastin e shitjes së numrit.

9. Taksat për veprime e shërbime nga administratat: gjyqësore, e Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme caktohen sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

10. Taksa e regjistrimit në arsimin e lartë është 200 lekë për çdo vit shkollor.

11. Taksat për shërbimet e radiokomunikacioneve caktohen sipas lidhjes nr.6, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

12. Taksat vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive caktohen sipas lidhjes nr.9, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

13. Taksa e kalimit me avion të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë caktohet:

a) për shtetasit e huaj 10 EURO për çdo kalim ose kundërvlefta në 10 EURO e monedhave të huaja, të konvertueshme;

b) për shtetasit shqiptarë 1 000 (një mijë) lekë për çdo kalim.

14. Taksa e pajisjes me pasaportë lundrimi caktohet 750 (shtatëqind e pesëdhjetë) lekë për çdo person.

15. Taksa e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit caktohet sipas lidhjes nr.7, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

16. Taksa e akteve dhe e pullës caktohet sipas lidhjes nr.5, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

17. Taksa për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport caktohet sipas lidhjes nr.8, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

18. Taksa e mbikalimeve ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë llogaritet në bazë të njësisë “unit rate”, e cila caktohet çdo vit nga Eurokontrolli.

19.Taksa e rentës minerare caktohet sipas ligjit nr.7796, datë 17.2.1994 “Ligji minerar i Shqipërisë”.

20. Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e luajtshme (automjete) është në masën 2 për qind të vlerës së pasurisë së kaluar dhe paguhet në çastin e kryerjes së aktit të kalimit të pronësisë. Për mjetet e prodhuara deri në dhjetë vjet nga çasti i kalimit të pronësisë, taksa është 2 për qind e vlerës, por jo më pak se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, ndërsa për mjetet e prodhuara mbi dhjetë vjet

nga çasti i kalimit të pronësisë, taksa është 2 për qind e vlerës, por jo më pak se 5 000 (pesë mijë) lekë.

21. Taksa e rrugës Durrës-Kukës:

a) mbitaksa për importet e taksueshme caktohet në masën 1 për qind për të gjitha mallrat e importuara, të taksueshme;

b) taksa mbi konsumin e karburantit caktohet në masën 3 lekë për litër për gazoilin, benzinën dhe benzolin, të cilat janë importuar ose prodhuar në vend;

c) taksa vjetore për tatimpaguesit e regjistruar në TVSH caktohet në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në vit.

22. Taksa e karbonit caktohet në masën 0,5 lekë për litër për benzinën dhe benzolin dhe 1(një) lek për litër për gazoilin. Kjo taksë zbatohet si për karburantet e importuara, ashtu edhe për ato të prodhuara në vend.

23. Taksa për ambalazhin plastik të lëngjeve caktohet në masën:

a) 2 lekë për copë për ambalazhet me kapacitet mbi 1,5 litra;

b) 1 lek për copë për ambalazhet me kapacitet 1,5 litra ose më pak se 1,5 litra.

Neni 6

Agjentët e taksave

Sipas llojit të taksave kombëtare, agjentët që ngarkohen me vjeljen e tyre janë:

1. Për taksat portuale ngarkohet kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare, shtetërore ose private.

2. Për taksat e shërbimeve konsullore ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Rendit Publik.

3. Për taksën vjetore të tonazhit të mjeteve për aks ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Drejtoria e Qarkullimit Rrugor pranë Ministrisë së Rendit Publik, nëpërmjet degëve në rrethe, kontrollon pagimin e kësaj takse nga zotëruesit e mjeteve.

4. Për taksën e qarkullimit të automjeteve të huaja ngarkohen degët e doganave në pikat e kalimit kufitar.

5. Për taksën e importimit të automjeteve të përdorura ngarkohen degët e doganave në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

6. Për taksën e pajisjes me lejedrejtimi për drejtim automjeti ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7. Për taksën për përdorimin e aparateve radiotelevizive ngarkohen zyrat e pagesës së energjisë elektrike. Zyrat e pagesës së energjisë elektrike transferojnë në llogarinë e degëve të tatimeve shumat e arkëtuara nga kjo taksë.

8. Për taksën për përdorimin e numrit telefonik ngarkohen operatorët përkatës, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë.

9. Për taksën për kryerjen e veprimeve e të shërbimeve administrative në: gjykata, Ministrinë e Drejtësisë, prokurori, noteri dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme ngarkohen administratat përkatëse të këtyre institucioneve.

10. Për taksën për regjistrimin në arsimin e lartë ngarkohen universitetet dhe shkollat e tjera të larta.

11. Për taksën për shërbimet e radiokomunikacioneve ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacionit (ERT).

12. Për taksën vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT).

13. Për taksën e kalimit me avion të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë ngarkohen organet doganore.

14. Për taksën për pajisjen e personave me pasaportë lundrimi ngarkohet Kapiteneria e Porteve.

15. Për taksën e ushtrimit të veprimtarisë së peshkimit ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Peshkimit.

16. Për taksën e akteve dhe të pullës ngarkohen zyrat e gjendjes civile.

17. Për taksën për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, nëpërmjet Albtransportit.

18. Për taksën e mbikalimeve ajrore mbi territorin e Republikës së Shqipërisë ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Trafikut Ajror (ANTA).

Të ardhurat nga taksat, sipas pikave 17 dhe 18 të këtij neni: taksa për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në aeroport dhe taksa e mbikalimeve ajrore të avionëve mbi territorin e Republikës së Shqipërisë, përdoren kryesisht për mirëmbajtjen dhe modernizimin e aeroportit të Rinasit ose të aeroporteve të tjera.

19. Për vjeljen e taksës së rentës minerare ngarkohen organet tatimore.

20. Për taksën për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e luajtshme (automjetet) ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

21. Për taksën e rrugës Durrës-Kukës:

a) për mbitaksën e importeve të taksueshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj;

b) për taksën e konsumit të karburantit ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për prodhuesit vendas të benzinës, gazoilit dhe benzolit;

c) për taksën vjetore nga tatimpaguesit e regjistruar në TVSH ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj.

Të ardhurat nga taksat e rrugës Durrës-Kukës përdoren vetëm për ndërtimin e rrugës Durrës-Kukës. Fondet e papërdorura brenda vitit mbarten në vitet pasardhëse.

22. Për vjeljen e taksës së karbonit ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj, për karburantin e importuar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj, për karburantin e prodhuar në vend.

23. Për vjeljen e taksës së ambalazheve plastike të lëngjeve të importuara ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj; për ambalazhet plastike të lëngjeve të prodhuara në vend ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj.

Neni 7

Transferimi i të ardhurave nga taksat kombëtare në Buxhetin e Shtetit

Taksa vjetore është e menjëhershme dhe paguhet brenda tremujorit të parë të vitit në vazhdim. Agjentët e taksave janë të detyruar t'i transferojnë taksat e vjelura në Buxhetin e Shtetit, brenda datës 30 të muajit, në të cilin janë arkëtuar taksat.

Kur detyrimi për pagimin e taksave vjetore për herë të parë lind në 6-mujorin e parë paguhet 100 për qind e taksës, ndërsa kur ky detyrim lind në 6-mujorin e dytë paguhet 50 për qind e masës së këtyre taksave.

Neni 8

Taksat që vilen nëpërmjet pullës dhe biletave

1. Taksat kombëtare që vilen nëpërmjet pullës janë si më poshtë:

a) taksat për shërbimet konsullore;

b) taksa vjetore e tonazhit për aks të mjeteve;

c) taksat me karakter administrativ për veprimet gjyqësore, të Ministrisë së Drejtësisë, prokurorisë, noterisë e të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme;

ç) taksat e akteve të gjendjes civile.

2. Taksa kombëtare që vilet nëpërmjet biletës së taksës është taksa e kalimit me avion të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave

Taksat arkëtohen nga agjentët e taksave, të përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.

Këto taksa transferohen të gjitha sipas tarifave të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji në llogaritë e të ardhurave tatimore të Buxhetit të Shtetit.

Për shërbimin që kryejnë, agjentëve të taksave u jepet komisioni përkatës në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje mbi masën e taksave që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në Buxhetin e Shtetit. Masa në përqindje e komisionit është si më poshtë:

1. Për taksat portuale (kapitenerisë së porteve)	4 për qind;
2. Për taksat për shërbimet konsullore	3 për qind;
3. Për taksën vjetore të tonazhit të mjeteve për aks	22 për qind;
e cila ndahet:	
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	20 për qind;
Drejtoria e Qarkullimit Rrugor pranë Ministrisë së Rendit Pubik	2 për qind.
4. Për taksën e qarkullimit të automjeteve të huaja	3 për qind;
5. Për taksën për importimin e automjeteve të përdorura	0 për qind;
6. Për taksën për pajisje me leje drejtimi për drejtim automjeti	5 për qind;
7. Për taksën për përdorimin e aparateve radiotelevizive	5 për qind;
8. Për taksën për përdorimin e numrit telefonik	5 për qind;
9. Për taksat për veprimet e shërbimit nga administrata gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, prokuroria, noteria dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	5 për qind.
Nga kjo:	
a) Për organet gjyqësore dhe zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	2 për qind;
b) Për noteritë	0 për qind;
c) Për subjektet, të autorizuara nga ligji nr.8002, datë 27.9.1995 “Për përdorimin dhe administrimin e pullave të taksave”, për shitjen e pullave të taksës	3 për qind;
10. Për taksën e regjistrimit në arsimin e lartë	2 për qind;
11.Për taksën e shërbimit të radiokomunikacioneve	5 për qind;
12. Për taksën vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive	5 për qind;
13. Për taksën për kalimin me avion të kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë	3 për qind;
14. Për taksën për pajisjen me pasaportë lundrimi	0 për qind;
15. Për taksën për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit	5 për qind;
16. Për taksën e akteve dhe të pullës	5 për qind;
17. Për taksën për ulje-ngritjen e avionëve dhe për qëndrimin e tyre në aeroport	3 për qind;
18. Nga të ardhurat e vjela nga taksa e mbikalimeve ajrore të avionëve në territorin e Republikës së Shqipërisë, përqindja që do t'i jepet Agjencisë Kombëtare të Trafikut Ajror është:	
Nga kjo përqindje jo më pak se 70 për qind është për investime.	80 për qind;
19. Për taksën e rentës minerare (Royalty)	0 për qind;
20. Për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e luajtshme (automjetet)	8 për qind;
21. Për taksën e rrugës Durrës-Kukës	0 për qind;
22. Për taksën e karbonit	0 për qind;
23. Për taksën e ambalazhit plastik të lëngjeve	0 për qind.

Komisionet e përfituara përdoren:

1. Në formën e shpërblimit mbi pagën për vështirësi në punë deri në masën 20 për qind të pagës për punonjësit që shërbejnë si agjentë tatimorë. Punonjësit që përfitojnë këto shpërblime, përcaktohen nga drejtuesit e subjekteve.

2. Në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave.

3. Për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

Neni 10

Përjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare

1. Përjashtohen nga pagimi i taksave portuale:

a) Anijet që transportojnë ndihma humanitare në Republikën e Shqipërisë:

i. anijet e shërbimeve detare në porte;

ii. anijet luftarake, spitalore, kabëllmbajtëse, si dhe anijet bazë dhe ato që u shërbejnë atyre për zonat e kërkimit e të shfrytëzimit të naftës në det.

b) Për anijet që prekin Portin e Durrësit, taksat portuale zbatohen në masën 100 për qind, kurse për anijet që prekin portet e Vlorës, Sarandës, Shëngjinit dhe pikën e benzinsjellësit në Vlorë,

taksat portuale zbatohen në masën 20 për qind më të ulëta.

c) Për anijet e personave fizikë dhe juridikë, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, taksat portuale zbatohen:

i) me 50 për qind zbritje për anijet me flamur shqiptar;

ii) me 20 për qind zbritje për anijet me flamur të huaj.

ç) Anijet me flamur shqiptar të personave fizikë ose juridikë, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, që kryejnë transport të brendshëm detar dhe peshkim, paguajnë taksën e anijes një herë, në prekjen e parë të çdo porti shqiptar dhe nuk paguajnë në hyrjet pasuese, gjatë vitit kalendarik.

2. Përjashtohen nga pagimi i taksave konsullore:

a) personat që janë pajisur me pasaportë diplomatike dhe shërbimi;

b) personat e organizatave bamirëse dhe filantropike;

c) punonjësit e Kryqit të Kuq dhe të Ligës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq;

ç) shtetasit e huaj me kombësi shqiptare;

d) shtetasit me dy nënshtetësi, shqiptare dhe të huaj;

dh) personat që shoqërojnë mjete me ndihma humanitare në bazë të marrëveshjeve ose të dërguara nga organizatat bamirëse, institucionet e ndryshme, individë të veçantë, ose qeveritë e huaja;

e) rastet e vdekjeve të shtetasve shqiptarë jashtë shtetit;

ë) në rastet e kërkuara nga autoritetet e larta zyrtare të huaja, nëse garantohet parimi i reciprocitetit.

3. Përjashtohen nga pagimi i taksës vjetore të tonazhit për aks:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë statusin diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) automjetet në pronësi të personave fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë brenda muajit janar të vitit në vazhdim se nuk do të qarkullojnë gjatë këtij viti kalendarik dhe dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit të automjetit.

4. Përjashtohen nga taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja:

a) automjetet e huaja, që sjellin ndihma humanitare falas;

b) mjetet që qarkullojnë me lejekalimi pa pagesë të taksave rrugore, mbi bazën e reciprocitetit;

c) mjetet e përfaqësive diplomatike e të shoqatave bamirëse.

5. Përjashtohen nga pagimi i taksës për aparatet radiotelevizive të gjitha institucionet shkollore dhe konviktet shtetërore të shkollave, si dhe institucionet shëndetësore shtetërore.

6. Përjashtohen nga pagimi i taksës për pajisjet me lejedrejtimi për drejtim automjeti, personeli i misioneve diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit.

7. Nga pagimi i taksës për shërbimet e radiokomunikacioneve përjashtohen:

a) përfaqësitë diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë;

b) organizatat bamirëse dhe filantropike të regjistruara në vendin tonë;

8. Nga pagimi i taksës së kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë përjashtohen:

a) personat që janë të pajisur me pasaportë diplomatike e shërbimi, si dhe anëtarët e delegacioneve të huaja presidenciale e qeveritare;

b) personat e organizatave bamirëse e filantropike;

c) punonjësit e Kryqit të Kuq, të Ligës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe misionaret e Nënë Terezës;

ç) anëtarët e familjeve të përfaqësuesve diplomatikë, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, që jetojnë bashkërisht;

d) anëtarët e personelit të misionit diplomatik, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, që punojnë në shërbimin administrativ dhe teknik të misionit, si dhe anëtarët e familjeve të tyre;

dh) personeli i avionit dhe personeli i shoqërive ajrore, në bazë të reciprocitetit;

e) fëmijët e pajisur me gjysmëbiletë për shtetasit shqiptarë, që shkojnë me shërbim jashtë shtetit, pagesa do të përballohet nga institucioni ose ndërmarrja, e cila i dërgon me shërbim.

9. Përjashtohen nga pagimi i taksës së akteve dhe të pullës:

a) veprimet zyrtare, që kërkohen nga autoritetet e huaja, në bazë reciprociteti;

b) regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile.

10. Përjashtohen nga pagimi i taksës për ulje-ngritjen e avionëve dhe qëndrimin e tyre në

aeroport:

a) avionët që transportojnë ndihma humanitare, shtetërore dhe shoqëritë bamirëse;

b) avionët që kryejnë detyra teknike për kalibrim pajisjesh lundruese, për llogari të Drejtorisë së Aviacionit Civil, si dhe avionët spitalorë e të kërkim-shpëtimit;

c) avionët ushtarakë, që nuk kryejnë veprime tregtare (transport udhëtarësh e ngarkim-shkarkim mallrash);

ç) avionët ushtarakë, që vijnë në Shqipëri, në kuadër të dërgimit të ndihmave humanitare falas për vendin tonë;

d) avionët, që vijnë për të marrë ose për të sjellë delegacione të larta shtetërore, të kryesuara nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri ose delegacione të larta ushtarake.

11.Përjashtohen nga pagimi i taksave të mbikalimeve ajrore në territorin e Republikës së Shqipërisë avionët ushtarakë.

Neni 11
Kundërvajtjet administrative

Përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:

a) mospagimi i taksave kombëtare nga personat e detyruar për t'i paguar;

b) falsifikimi i të dhënave dhe i dokumentacioneve bazë për llogaritjen e tyre nga personat që duhet të paguajnë taksa;

c) mosllogaritja ose mostransferimi në Buxhetin e Shtetit, në mënyrë korrekte dhe në kohën e duhur, i taksave kombëtare nga agjentët e taksave;

ç) mosmbajtja në mënyrë korrekte e regjistrimeve të taksave të arkëtuara nga agjentët e taksave;

d) mosdhënia nga agjentët për organet tatimore e të dhënave të kërkuara për llogaritjet e taksave.

Neni 12
Dënimet

1. Shkeljet e parashikuara në nenin 11 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) për shkeljet sipas shkronjave “a” dhe “b” të nenit 11, personat që nuk kanë paguar taksat dënohen me gjobë 5 mijë deri në 20 mijë lekë dhe vjeljen në masë të plotë të saj;

b) për shkeljet sipas shkronjës “c” të nenit 11, agjentët e taksave dënohen me gjobë të barabartë me shumën e taksës së pallogaritur ose të patransferuar në Buxhetin e Shtetit, si dhe me vjeljen në masë të plotë të saj.

c) për shkeljet sipas shkronjës “ç” të nenit 11, agjentët e taksave dënohen me gjobë 10 mijë deri në 50 mijë lekë;

ç) për shkeljet sipas shkronjës “d” të nenit 11, agjentët e taksave dënohen me gjobë 50 mijë lekë.

2. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 13
Shfuqizimet

Ligji nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, shfuqizohet.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3610, datë 20.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIDHJA NR. 1
NIVELI I TAKSAVE PORTUALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në EURO

Lloji i taksave	Për çdo ton neto të regjistrit të anijeve	Gjithsej për çdo anije
Taksa portuale:		
Taksë e anijes:		
Për anije që ngarkojnë e shkarkojnë mallra të përgjithshme	0,4	
Për anije që ngarkojnë e shkarkojnë mallra të lëngshme	0,6	
Për anijet traget RO/RO dhe të udhëtarëve		
Për anijet sportive, jahte:	0,35	
Deri 30TRN		
Nga 31 deri 70 TRN		15
Taksë feneri:		30
për anijet deri në 200 TRN		
për anijet nga 201 deri 500 TRN	0,10	
për anijet mbi 501 TRN		20
Taksë për formalitetet e kryera nga organet e shëndetësisë, kapitenerisë së porteve dhe autoritetet e tjera :		50
për anijet deri në 200 TRN		
për anijet nga 201 deri 500 TRN	0,25	
për anijet nga 501 deri 2000 TRN	100	
për anijet nga 2001 deri 4000 TRN	180	
për anijet mbi 4001 TRN	210	
	300	

4. Anijet që ngarkojnë ujë për eksport në pikat jashtë porteve, paguajnë taksa portuale gjithsej në masën 300 EURO për çdo rast furnizimi.

5. Anijet e huaja i paguajnë taksat portuale në valutë lirisht të konvertueshme, kurse anijet e personave juridikë a fizikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë paguajnë në valutë ose në lekë në raport me realizimin e të ardhurave.

6. Taksat portuale paguhen në prekjen e parë të çdo porti shqiptar, pavarësisht se anija do të shkojë për veprime tregtare dhe në porte të tjera shqiptare në të njëjtin rejs.

LIDHJA NR. 2
TAKSAT PËR SHËRBIMET KONSULLORE

I. Taksat për lëshimin e vizave dhe dokumenteve të udhëtimit:

1. Për lëshimin e pasaportave të udhëtimit :2000 lekë
2. Për lëshimin e pasaportave të udhëtimit nga përfaqësitë50 EURO
3. Zgjatja e pasaportës nga përfaqësitë15 EURO
4. Për leje kalimi200 lekë
5. Leje kalimi lëshuar nga përfaqësitë30 EURO
6. Taksa e vizës për shtetasit e huajReciprocitet
7. Taksa e vizës për shtetasit e huaj që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë me grupe turistike nëpërmjet shoqërive turistike reciprocitet, por jo më shumë se 10 EURO.

8. Taksa e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për shtetasit e huaj, që nuk kanë nevojë për vizë, do të jetë sipas parimit të reciprocitetit, por jo më shumë se 10 EURO.

9. Taksa e hyrjes së shtetasve të huaj që nuk kanë nevojë për vizë dhe që hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë me grupe turistike nëpërmjet shoqërive turistike, reciprocitet, por jo më shumë se 10 EURO.

Kjo taksë nuk zbatohet për periudhën 1 maj- 1 nëntor.

10. Turistët individualë njëditorë dhe ata të organizuar në grupe turistike njëditorë nuk paguajnë taksë vize ose taksë hyrjeje.

II. Taksat për lëshimin, verifikimin dhe legalizimin e dokumenteve:

1. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit
shqiptarë 30 EURO

2. Certifikatë të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit
e huaj Reciprocitet

3. Vërtetime të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit
shqiptarë30 EURO

4. Vërtetime të çdo lloji lëshuar nga përfaqësitë për shtetasit
e huajReciprocitet

5. Verifikimi i dokumentit nga përfaqësitë10 EURO

6. Legalizimi i dokumentit për shtetasit shqiptarë nga
Ministria e Punëve të Jashtme200 lekë

7. Legalizimi i dokumentit nga përfaqësitë për
shtetasit shqiptarë 30 EURO

8. Legalizimi i dokumentit për shtetasit e huajReciprocitet

III. Taksat për lëshimin e përpilimin e akteve të tjera noteriale dhe përkthimin e dokumenteve nga përfaqësitë

1. Përpilimi i deklaratave, autorizimeve, testamenteve kontratave, garancive dhe prokurave të posaçme nga përfaqësitë20 EURO/ faqe

2. Vërtetimi i dublikatave dhe kopjeve20 EURO/ faqe

3. Përkthimi i dokumenteve10 EURO/ faqe

Shënim: Me termin përfaqësi kuptohet përfaqësia diplomatike ose konsullore jashtë shtetit.

Taksa mund të arkëtohet edhe në dollarë ose në monedhën e vendit, duke pasur parasysh kursin e këmbimit.

LIDHJA NR. 3
TAKSAT VJETORE TË TONAZHIT PËR AKS TË MJETEVE

Nr.	Tipi i mjetit	Masa e taksës për një aks në lekë
1.	Autoveturë dhe mikrobus me më shumë se (4 + 1 (dhe me më pak ose e barabartë me (8 + 1) vende	5 000
2.	Autobus me më pak ose i barabartë me (32 + 1) vende	10 000
3.	Autobus me më pak ose i barabartë me (42 + 1) vende	13 000
4.	Autobus me më shumë se (42 + 1) vende	15 000
5.	Furgon dhe kamionçinë me peshë maksimale të autorizuar më të vogël Ose të barabartë me 3 tonë	5 000
6.	Furgon dhe kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 3 dhe deri ose Të barabartë me 3,5 tonë	10 000
7.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 3,5 dhe deri ose të barabartë me 7,5 tonë	15 000

8.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 dhe deri me 18 tonë ose të barabartë	18 000
9.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 18 tonë	23 000
10.	Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, karkalec etj.(Me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë Me 7,5 tonë	15 000
11.	Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, fadromë etj.(me Peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 tonë	18 000
12.	Mjete ndërtimi)autovinça, autobetoniere etj.) me peshë maksimale të autorizuar deri ose të barabartë me 7,5 tonë	20 000
13.	Mjete ndërtimi)autovinça, autobetoniere etj.) me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 dhe deri ose të barabartë me 18 tonë	24 000
14.	Mjete ndërtimi)autovinça, autobetoniere etj.) me peshë maksimale të autorizuar mbi 18 tonë	30 000
15.	Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë me 7 tonë	7 500
16.	Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar mbi 7 tonë	10 000

Shënim: Vlerat e taksave në tabelën e mësipërme janë vetëm për një aks. Pagesa e plotë e taksës do të jetë sa vlera e taksës për një aks shumëzuar me numrin e akseve.

LIDHJA NR. 4
TAKSA E QARKULLIMIT TE AUTOMJETEVE TË HUAJA

në EURO

1. Për veturat e udhëtarëve për çdo ditë apo pjesë të ditës1
2. Për mikrobuzët2
3. Për autobuzët për udhëtarë për çdo km në tokën shqiptare (Kjo taksë nuk mund të jetë më e vogë se 5 EURO për çdo ditë) 0,002
4. Për kamionët e rimorkiot e kamionëve për çdo ton/km në tokën shqiptare (Kjo taksë nuk mund të jetë më e vogël se 8 EURO për çdo ditë). 0,02
5. Kur automjetet kalojnë pa ngarkesë paguajnë 50% të taksës.

LIDHJA NR. 5
TAKSA PËR VEPRIMET DHE SHËRBIMET QË KRYHEN NGA ADMINISTRATA GJYQËSORE, MINISTRIA E DREJTËSISË, NOTERIA, ZYRAT E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PROKURORIA DHE ZYRAT E GJENDJES CIVILE

A. Taksa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokuroria:	Masa e taksës në lekë	në %
1. Për regjistrimin e personave fizikë e juridikë privatë (shtetas shqiptarë)	1 000	
2. Për regjistrimin e personave juridikë privatë (shtetas të huaj)	4 500	
3. Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit	100	
4. Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çd dokumenti që kërkohet nga të interesuarit	100	
5. Për lëshimin e dëshmisë së penalitetit nga zyrat e gjendjes gjyqësore	100	

6. Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Drejtësisë	100	
7. Kërkesë padi që paraqiten në gjykatë:		
a) për pension ushqimor	-	
b) për vërtetim fakti	100	
c) padi për zgjidhje martese	1 500	
ç) padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike	1 500	
d) padi të rjedhura nga marrëdhënie kontraktore si dhe për shkaktim dëmi		
i.me vleftë deri 100 000 lekë	1 500	
ii. me vleftë mbi 100 000 lekë		1%
dh) padi për pjesëtim pasurie	1 500	
e) padi për kthim në punë	-	
B. Taksë për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor:		
1. Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të pavleftësueshëm	750	
2. Për vënien në ekzekutim të vendimeve e titujve të tjerë ekzekutivë me objekt të vleftësueshëm:		
a) kundrejt shtetasve		3%
b) kundrejt personave juridikë		7%
3. Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të përmbaruesit gjyqësor	100	
4. Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar nga të interesuarit	100	
5. Për vënien në ekzekutim të vendimeve me objekt pension ushqimor	-	
C. Taksat për veprimet që kryhen nga zyrat noteriale:		
1. Përpilimi i testamenteve me akte noteriale	450	
2. Përpilimi i testamenteve olografe (me vërtetim firme)	200	
3. Prokura (redaktim):		
a) të përgjithshme	150	
b) të posaçme	150	
4. Për lëshimin e kopjeve, shkurtime e pjesë të akteve të depozituara në zyrën noteriale	150	
5. Vërtetim se kopjet ose shkurtimet e dokumenteve janë të njëjta me origjinalin	150	
6. Vërtetim përkthimi dhe vërtetim njësie me origjinalin	100	
7. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së luajtshme	700	
8. Kontrata për kalim pronësie të pasurisë së paluajtshme	1 000	
9. Redaktimi i akteve noteriale të ndryshme	150	
10. Njoftim dhe kujtesë noteriale ose akte të tjera jashtëgjyqësore	150	
11. Legalizim i nënshkrimit të shtetasve në akte të ndryshme	100	
12. Depozitimi i kapitalit themelor për themelimin e një shoqërie në bazë të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 «Për shoqëritë tregtare»	300	
13. Pranimi për ruajtje të dokumenteve të personave fizikë dhe juridikë në zyrat noteriale	300	
14. Vërtetimi i qenies së një personi dhe qëndrimi i tij në një vend të caktuar	150	
15. Veprime të tjera noteriale	100	
Ç.Taksat për veprimet që kryhen nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme:		
1. Kërkesa për regjistrimin e pronësisë të pasurisë së paluajtshme	300	
2. Kërkesa për regjistrimin e pjestimit, ndarjes ose bashkimit të pasurisë së paluajtshme	300	
3. Kërkesa për përgatitjen e dokumenteve për në gjykatë ose organ tjetër administrativ	150	
4. Kërkesa për regjistrimin për kalim pronësie, qiraje, nënqiraje	300	
5. Kërkesa për regjistrim hipoteke ligjore	150	
6. Kërkesa për regjistrim përfshirje hipoteke ligjore	150	
7. Kërkesa për regjistrim përfshirjen e një vendimi gjykate a të një akti administrativ	150	
8. Kërkesa për regjistrim servituti, marrëveshjeje kufizuese	150	
9. Kërkesa për regjistrim për fshirjen e një servituti, marrëveshjeje kufizuese	150	
10. Regjistrimi i kërkesave për heqjen dorë nga të drejtat pasurore mbi pasurinë e paluajtshme	100	
11. Regjistrimi i kërkesave për fitimin e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme me trashëgimi	300	

12. Kërkesa për regjistrimin e veprimeve juridike mbi pasurinë paluajtshme nga personat fizikë dhe juridikë me banim jashtë shtetit	300
13. Për lëshimin e certifikatave të pasurisë	100
14. Për lëshimin e çdo kopjeje të certifikatës së pasurisë	50
15. Për lëshimin e çdo akti të të interesuarve për veprimet hipotekore	50
D. Taksa e akteve dhe e pullës :	
Për lëshimin e certifikatave të gjendjes civile	50
2. Për lëshimin e pasaportave për brenda vendit	100
3. Për marrjen e çdo akti të emetuar ose të zhdukur të gjendjes civile, si dhe për korrigjimet e tyre	50
4. Për regjistrimin e dhënies së shtetësisë	700
5. Për regjistrimin e lënies së shtetësisë	700
6. Për regjistrimin e vendimit të ndërrimit të emrit ose mbiemrit	700
7. Për çdo lidhje martese	600

LIDHJA NR. 6
TAKSAT PËR SHËRBIMET E RADIOKOMUNIKACIONIT

PJESA A
TAKSAT PËR SHËRBIMET PRIVATE TË RADIOKOMUNIKACIONIT

I. Shërbimi aeronautik:

1. Stacion bazë në tokë	10 000 lekë në vit
2. Stacion i lëvizshëm në tokë	7 500 lekë në vit
3. Stacion portativ në tokë	5 000 lekë në vit
4. Terminal satelitor në avion	40 000 lekë në vit
5. Radaret dhe pajisjet e radionavigacionit aeronautit	3 000 lekë në vit
	për çdo pajisje
6. Stacionet e avionit me aftësi ngritëse	
deri në 3 200 kg	5 000 lekë në vit
mbi 3 200 deri në14 000 kg	40 000 lekë në vit
mbi 14 000 kg	80 000 lekë në vit
II. Shërbimi detar:	
1. Stacion bregdetar	10 000 lekë në vit
	për çdo stacion bazë
2. Radarë dhe pajisje radionavigimi	2 500 lekë në vit
	për çdo pajisje
3. Radio për operacione portuale	1 500 lekë në vit
	për çdo radio
4. Stacion bazë në anije (HF, VHF, UHF)	5 000 lekë në vit
	për çdo radio
5. Stacion portativ (VHF) në anije	1 000 lekë në vit
	për çdo radio
6. Terminal satelitor në anije INMARSAT	3 000 lekë në vit
III. Shërbimi satelitor:	
1. Stacion tokësor fiks:	
- analog me gjerësi brezi deri në 100 kHz	150 000 lekë në vit
- me gjerësi brezi mbi 100 deri në 1MHz	500 000 lekë në vit
- me gjerësi brezi mbi 1 MHz	1 200 000 lekë në vit
- dixhital me kapacitet deri në 64 kbps	25 000 lekë në vit
deri në 2 Mb/s	75 000 lekë në vit
mbi 2 Mb/s deri në 8 Mb/s	300 000 lekë në vit
mbi 8 Mb/s	700 000 lekë në vit
2. Stacion tokësor i transportueshëm (në automjete)	800 000 lekë në vit
3. Stacion portativ VSAT (çantë, valixhe)	30 000 lekë në vit
4. Stacion tokësor i transportueshëm me afat qëndrimideri në një muaj në vendin tonë	60 000 lekë në vit
5. Stacion portativ VSAT (çante, valixhe) me afat qëndrimi deri në 6 muaj në vendin tonë	15 000 lekë në vit

IV. Shërbimi i lëvizshëm në tokë:	

1. Shërbim i lëvizshëm (PMR), në brezin 146 MHz deri në 470 MHz

A. Sisteme dupleks e gjysmëdupleks me gjerësi kanali deri 12,5 Khz :

Zona e shërbimit Lidhje midis dyLidhje stacioni fiks
stacioneve përsëritësme stacion të lëvizshëm
dhe/ose stacion i
lëvizshëm me stacion
të lëvizshëm
deri në 10 km15 000 lekë në vit10 000 lekë në vit
mbi 10 deri në 30 km25 000 lekë në vit20 000 lekë në vit
mbi 30 deri në 50 km55 000 lekë në vit40 000 lekë në vit
mbi 50 km80 000 lekë në vit65 000 lekë në vit

Ky nivel taksash zbatohet për sisteme që kanë deri në 10 stacione të lëvizshme.

B. Për sisteme të njëjta me ato të pikës 1.A, por me numër më të madh stacionesh të lëvizshme, zbatohen taksat e mëposhtme:

- për sistem me 11 deri në 25 stacione taksës përkatëse të pikës 1.A i shtohet po ajo vlerë me koefiçent reduktimi 0,8
- për sistem me 26 deri në 40 stacione taksës së mësipërme i shtohet taksa e pikës 1.A me koefiçent reduktimi 0,6
- për sistemin që ka mbi 40 stacione taksës së mësipërme i shtohet taksa e pikës 1.A me koefiçent reduktimi 0,4

C. Për sistemet me gjerësi kanali 25 kHz taksa e llogaritur si në 1.A dhe 1.B të shumëzohet me koeficentin 1,5

Ç. Për sitemet simplekse zbatohen taksat përkatëse të pikave 1.A dhe 1.B me koefiçent reduktimi 0,5

2. Sistem “trunk” kombëtar

100 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 12,5 kHz
150 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 25 kHz

3. Sistemi “trunk” rajonal

30 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 12,5 kHz
40 000 lekë në vit për çdo kanal me gjerësi 25 kHz

4. Sistem TETRA

50 000 lekë në vit për sistem kombëtar për çdo kanal 25 kHz
20 000 lekë në vit për sistem rajonal për çdo kanal 25 kHz

V. Shërbimi fiks për operatorët e telekomunikacioneve:

Lidhje dydrejtimshe:
Sistem në brezin deri 80 MHz80 000 lekë në vit për çdo kanal 3 kHz
Sistem në brezin 80 deri në 500 MHz40 000 lekë në vit për çdo kanal 25 kHz
Sistem në brezin 500 deri në 1000 MHz 25 000 lekë në vit për çdo kanal 200 kHz
50 000 lekë në vit për çdo kanal mbi 200 kHz.
Sistem në brezin mbi 1000 MHz
a) analog: për çdo kanal me gjerësi deri në 1 MHz30 000 lekë në vit
për çdo kanal me gjerësi deri në 10 MHz40 000 lekë në vit
për çdo kanal me gjerësi mbi 10 MHz60 000 lekë në vit
b) dixhital: për kapacitet deri në128 kb/s5 000 lekë në vit
për kapacitet deri në 2 Mb/s 20 000 lekë në vit
për kapacitet deri në 8 Mb/s 30 000 lekë në vit
për kapacitet deri në 34 Mb/s 40 000 lekë në vit
për kapacitet mbi 34 Mb/s 50 000 lekë në vit

Shënim : Me lokal do të kuptohet mbulimi i territorit në nivel rrethi. Me rajonal do të kuptohet mbulimi i territorit të disa rretheve. Me kombëtar do të kuptohet mbulimi i 50% të territorit shqiptar.

PJESA B
TAKSAT PËR SHËRBIMET PUBLIKE TË RADIOKOMUNIKACIONEVE

1. Shërbimi fiks tokësor
- Për përdorim joekskluziv të frekuencave:
Sistem analog (radio-rele) 3 000 lekë në vit për çdo kanal telefonik 3 kHz
Sistem dixhital (radio-rele)1 500 lekë në vit për çdo kanal telefonik 64 kHz
Sistem dixhital (radio-rele) 20 000 lekë në vit për çdo link 2 Mbit/sek
Sisteme radio të telefonisë rurale 1 000 lekë në vit për çdo kanal telefonik
- Për përdorim ekskluziv të frekuencave në nivel kombëtar:
Në brezin UHF100 000 lekë në vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të përdorur
Në brezin 1-5 Ghz 60 000 lekë në vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të përdorur
Në brezin 5-11Ghz 40 000 lekë në vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të përdorur
Në brezin mbi 11 Ghz 20 000 lekë në vit për çdo 1 Mhz gjerësi brezi të përdorur
2. Shërbim fiks satelitor:
Sistem analog5 000 lekë në vit për çdo kanal telefonik 3 kHz
Sistem dixhital3 000 lekë në vit për çdo kanal telefonik 64 kHz
3. Shërbim i lajmërimit të personit (Pager):
Lidhje ndërmjet stacioneve fikse (bazë-përsëritës)40 000 lekë në vit
për çdo hop radio
Për çdo stacion bazë30 000 lekë në vit
4. Shërbim i lëvizshëm telefonik (GSM) 150 000 lekë në vit
për çdo kanal 200 kHz
5. Shërbim internet
Lidhje me sistem satelitor10 000 lekë në vit për çdo njësi 64 kb/s
Lidhje me sistem radio-rele 1 500 lekë në vit për çdo njësi 64 kb/s
6. Shërbim telefonik satelitor (GMPCS) 4 000 EURO në vit

LIDHJA NR. 7
TAKSA VJETORE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
PESHKIMIT

Lekë në vit
I. Peshkimi detar (për 1 anije)
1. Peshkimi detar fundor:
- anije 160-200 HP40 000
- anije 201-410 HP50 000
- anije mbi 410 HP80 000
2. Peshkimi pellagjik me tratavolante:
- anije 160-200 HP20 000
- anije 201-410 HP30 000
- anije mbi 410 HP40 000
3. Peshkimi pellagjik me rrethime:
- anije 80-200 HP10 000
- anije 201-410 HP20 000
- anije mbi 410 HP30 000
4. Peshkimi pellagjik dhe fundor:
- anije 160-200 HP40 000
- anije 201-410 HP60 000
- anije mbi 410 HP90 000
5. Peshkimi me mjete selektike dhe trata fundore:
- anije 40 - 80 HP15 000
- anije 81-160 HP25 000
- anije 161-200 HP40 000
- anije 201-410 HP50 000

- anije mbi 410 HP80 000
6. Peshkimi i molusqeve bivalvore60 000
(i autorizuar)
II. Peshkimi artizanal me mjete të lehta:
1. Peshkimi në bregdet (për një sanall dhe me motor
deri në 40HP)7 000
2. Peshkimi në lagunat bregdetare:
- në lagunë (1 lundror)10 000
- në dajlane (1 peshkatar)12 000
3. Peshkimi në ujëra të brendshme:
- aktiv (1 lundror) 5 000
- në dajlane e prita (1 peshkatar) 8 000
4. Grumbullimi i molusqeve bivalvore
me mjete të lehta (gabie) për 1(një) peshkatar 20 000
III. Peshkimi sportiv në det
me mjete lundruese (për 1 mjet) 40 000
IV. Akuakultura:
1. Kultivimi i midhjeve për një impiant10 000
2. Kultivimi i peshqëve me impiante në
det, në liqene, në rezervuarë 1 000
3. Akuakulturë me impiante në tokë10 000

Shënim: Për anijet e huaja që do të marrin licencë peshkimi në ujërat tona territoriale, taksa e lejes së ushtrimit të veprimtarisë do të jetë sa dyfishi i anijeve shqiptare. Nuk i nënshtrohen kësaj takse anijet e autorizuara nga Mininistria e Bujqësisë dhe Ushqimit (Drejtoria e Peshkimit), që do të peshkojnë për qëllime studimore e shkencore.

LIDHJA NR. 8
NIVELI I TAKSAVE PËR ULJEN DHE NGRITJEN E AVIONËVE DHE QËNDRIMIN E TYRE

1. Taksat për ulje-ngritje të avionit:
EURO
Për avionë deri në 1 ton 25
mbi 1 deri në 2 tonë 35
mbi 2 deri në 6 tonë 70
mbi 6 deri në 10 tonë120
mbi 10 deri në 20 tonë200
mbi 20 deri në 30 tonë300
mbi 30 deri në 45 tonë400
mbi 45 deri në 60 tonë550
mbi 60 deri në 80 tonë650
mbi 80 deri në 100 tonë700
mbi 100 deri në 120 tonë800
mbi 120 tonë900
2. Taksat e qëndrimit në aeroport:
(3 deri në 24 orë)
deri në 1 ton 8
mbi 1 deri në 2 tonë12
mbi 2 deri në 6 tonë35
mbi 6 deri në 10 tonë 40
mbi 10 deri në 20 tonë 60
mbi 20 deri në 30 tonë 80
mbi 30 deri në 45 tonë100
mbi 45 deri në 60 tonë130
mbi 60 deri në 80 tonë140

mbi 80 deri në 100 tonë150
mbi 100 deri në120 tonë170
mbi 120 tonë e lart200

- Pesha bazë për pagesën e taksave të mësipërme do të konsiderohet pesha maksimale e ngritjes së avionit (MTOW).
- Kur fluturimet kryhen ditët e diela, festa zyrtare, fetare si dhe jashtë orarit të punës së aeroportit, me përjashtim të avionëve të linjave të rregullta, taksave të mësipërme u bëhet një shtesë 50 për qind.
- Në rast se avioni që është ngritur nga aeroporti detyrohet të riulet, për shkaqe të kushteve atmosferike ose defekteve, taksat për uljen e përsëritur do të jenë 50 për qind më të ulëta.

LIDHJA NR.9
TAKSAT VJETORE PËR SHËRBIMET E TRANSMETIMEVE RADIO E TELEVIZIVE

Për transmetuesit ose përsëritësit televizivë analogë tokësorë, radio FM tokësore, radio AM të operatorëve privatë radio e televizivë, kombëtarë e vendorë:

1. Për çdo transmetues ose përsëritës televiziv analogjik tokësor
a) me fuqi të rrezatuar deri në 10W 1 500 lekë në vit
b) me fuqi të rrezatuar deri në 100 W 6 000 lekë në vit
c) me fuqi të rrezatuar deri në 1000W 24 000 lekë në vit
ç) me fuqi të rrezatuar deri në 10000W48 000 lekë në vit
d) me fuqi të rrezatuar mbi 10000W60 000 lekë në vit
2. Për çdo transmetues ose përsëritës radio FM tokësore:
a) me fuqi të rrezatuar deri në 10W 300 lekë në vit
b) me fuqi të rrezatuar deri në 100 W 1 200lekë në vit
c) me fuqi të rrezatuar deri në 1000W 4 800lekë në vit
ç) me fuqi të rrezatuar deri në 10000W 9 600lekë në vit
d) me fuqi të rrezatuar mbi 10000W 12 000lekë në vit

3. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e qytetit të Tiranës, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 5.
4. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi mbi 100 000 banorë, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 2.
5. Në qoftë se një nga transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulon mbi gjysmën e një qyteti me popullsi 50 000 deri në 100 000 banorë, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet me koeficientin 1,5.
6. Në qoftë se transmetuesit ose përsëritësit 1.b, 1.c, 1.ç, 1.d, 2b, 2c, 2ç, 2d, mbulojnë dy ose më shumë qytete të cituara në pikat 3,4,5, atëherë taksa e llogaritur në këto pika shumëzohet vetëm një herë me koeficientin më të lartë.
7. Për çdo transmetues AM 200 000 lekë në vit.

Operatorët radio dhe/ose televizivë të ritransmetimit të programeve të huaja me përsëritës të licencuar nga KKRT-ja paguajnë vetëm 20 për qind të taksave të përcaktuara më sipër.

L I G J
Nr. 8978, datë 12.12.2002

PËR TAKSËN VENDORE PËR BIZNESIN E VOGËL

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 155 dhe 157 pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1
Kuptimi i taksës vendore për biznesin e vogël

Taksa vendore për biznesin e vogël është një taksë vendore, e klasifikuar si e ardhur e bashkive dhe komunave, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".

Neni 2
Subjekti dhe objekti i ligjit

1. Objekt i taksës vendore për biznesin e vogël është një kuotë fikse vjetore, e pagueshme, e realizuar për çdo vendndodhje ku një person kryen biznes.

2. Subjekt i taksës vendore për biznesin e vogël është çdo person, që kryen biznes në territorin e njësive të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, në çdo periudhë të vitit kalendarik, dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar, TVSH-së.

Neni 3
Përkufizime

Termat e mëposhtëm, në kuptim të këtij ligji, nënkuptojnë:

1. "Organ tatimor" quhet zyra e taksave, e caktuar për ta administruar këtë taksë.

2. "Biznes" është çdo veprimtari ekonomike, që ka për qëllim realizimin e fitimit.

3. "Vendndodhje e biznesit" është çdo dyqan, njësi e veçantë ose vende të tjera të palëvizshme, ku kryhet biznesi. Kur nuk ekziston një vend fiks biznesi, vendndodhja e biznesit, për qëllime të këtij ligji, përcaktohet në përputhje me pikën 7 të nenit 6 të këtij ligji.

4. "Udhëzim" është udhëzimi i përbashkët, i lëshuar nga Ministri i Financave dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në zbatim të këtij ligji.

5. "Person" është çdo person fizik ose juridik, që kryen veprimtari biznesi.

6. "Taksë" është taksa vendore për biznesin e vogël, e vendosur nga ky ligj.

7. "Taksapagues" është çdo person, i cili, sipas këtij ligji, është subjekt i taksës vendore për biznesin e vogël.

8. "Nivel tregues" quhet niveli i taksës vendore për biznesin e vogël, i parashikuar në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 4
Organi tatimor

Për dy vitet e para nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, organet tatimore janë degët e tatimeve, me përjashtim të rasteve kur organi tatimor caktohet nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në rekomandimin e Ministrit të Financave, në përputhje me kërkesën e organeve të pushtetit vendor.

Neni 5
Nivelet e taksave dhe detyrimi për taksat

1. Çdo biznes, në çdo vendndodhje të biznesit, taksohet më vete.

2. Detyrimi i taksës për t'u paguar për çdo biznes, në çdo vendndodhje biznesi, përcaktohet në përputhje me kategorinë e biznesit që kryhet në kohën e regjistrimit dhe riregjistrimit. Kategoritë e biznesit paraqiten në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

3. Kur një person kryen më shumë se një veprimtari në të njëjtin vend, niveli tregues i taksës përcaktohet sipas veprimtarisë me qarkullim më të madh.

4. Niveli tregues përcaktohet me kuotë fikse për çdo kategori biznesi, që përcaktohet në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Këshilli i bashkisë ose këshilli i komunës në të cilën është vendndodhja e biznesit, mund të rrisë ose të ulë masën e niveleve treguese jo më shumë se 30 për qind. Çdo rritje ose ulje zbatohet në të njëjtën mënyrë për të gjitha kategoritë e biznesit.

5. Bashkia ose komuna njofton organin tatimor për kuotat fikse të taksës që do të zbatohen për vitin kalendarik pasardhës jo më vonë se data 15 dhjetor e vitit në vazhdim. Nëse bashkia ose komuna nuk e bën një gjë të tillë, organi tatimor zbaton automatikisht nivelet treguese, të përcaktuara në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

6. Nëse biznesi fillon ose pushon së vepruari gjatë vitit ose ndërpritet përkohësisht, detyrimi i taksës për atë vit llogaritet në bazë të numrit të muajve efektivë të veprimtarisë. Metoda e llogaritjes së taksës, metoda e deklarimit të mbylljes së përkohshme të biznesit, periudha e lejuar për mbylljen e përkohshme dhe mënyra e zvogëlimit të detyrimit për taksën përcaktohen në udhëzim.

7. Udhëzimi përcakton rastet kur, për qëllime të taksimit, një veprimtari ekonomike, në një vendndodhje të biznesit, është e përbërë nga një ose disa biznese.

Neni 6
Kërkesat për regjistrim

1. Taksapaguesi do të regjistrojë çdo vendndodhje të biznesit në organin tatimor përgjegjës për atë vendndodhje. Regjistrimi bëhet përpara se taksapaguesi të fillojë biznesin.

2. Gjatë regjistrimit, taksapaguesi detyrohet të japë të dhënat e mëposhtme:

a) vendimin e gjykatës për regjistrimin;

b) certifikatën personale me fotografi;

c) adresën e vendndodhjes ose vendndodhjeve të biznesit;

ç) llojin e biznesit ose bizneseve që kryhen në atë vendndodhje;

d) numrin e identifikimit të taksapaguesit, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

dh) numrin e regjistrimit në degën e taksave të pushtetit vendor;

e) çdo të dhënë ose dokument tjetër që kërkohet nga udhëzimi.

3. Taksapaguesi, pas regjistrimit fillestar, riregjistrohet në çdo vit kalendarik që vijon dhe jo më vonë se data 31 mars. Procedura e riregjistrimit përcaktohet në udhëzim.

4. Kur taksapaguesi nuk regjistrohet ose nuk riregjistrohet në kohën e duhur, ai regjistrohet nga organi tatimor. Ky regjistrim ka të njëjtin efekt me regjistrimin ose riregjistrimin e bërë nga taksapaguesi dhe shoqërohet me sanksione, sipas nenit 12 pika 1.a të këtij ligji.

5. Organi tatimor përgjegjës pajis me certifikatë regjistrimi çdo taksapagues, i cili ka përfunduar procesin e regjistrimit në përputhje me udhëzimin. Certifikata tregon numrin e identifikimit të taksapaguesit, llojin e veprimtarisë dhe adresën e vendndodhjes së biznesit, si dhe numrin e regjistrimit në zyrën e taksave të pushtetit vendor.

6. Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit.

7. Nëse taksapaguesi nuk ka një vendndodhje fikse, ku ushtron ndonjërin nga bizneset e tij, atëherë:

a) në rastin e një personi fizik, vendndodhja e ushtrimit të biznesit quhet banesa private e taksapaguesit;

b) në rastin e një personi juridik, vendndodhja e biznesit quhet selia e përcaktuar në vendimin e gjykatës.

Neni 7
Detyrimi për informim

1. Taksapaguesi njofton me shkrim organin tatimor përgjegjës për çdo ndryshim në të dhënat e paraqitura, kur është regjistruar ose riregjistruar. Mënyra dhe forma e njoftimit përcaktohen në udhëzim.

2. Taksapaguesi detyrohet të afishojë dukshëm, në vendndodhjen e biznesit, certifikatën e regjistrimit që i është lëshuar nga organi tatimor përgjegjës. Nëse nuk kemi një vendndodhje fikse për veprimtarinë ekonomike, taksapaguesi detyrohet ta paraqesë certifikatën sa herë që i kërkohet nga

punonjësi i organeve tatimore.

Neni 8
Shkëmbimi i të dhënave

1. Udhëzimi përcakton procedurat e bashkëpunimit ndërmjet organeve tatimore qendrore dhe bashkive ose komunave për administrimin e këtij ligji.

2. Ky bashkëpunim përfshin jo vetëm shkëmbimin e të dhënave ndërmjet organeve qendrore dhe vendore për shumën e mbledhur të taksës, e cila bëhet jo më pak se një herë në 3 muaj, por edhe të dhëna për taksapaguesit, në rastet kur kërkohet të njihet efektiviteti i mbledhjes së taksës.

3. Ky bashkëpunim dhe shkëmbim të dhënash përfshin dhënien në kohë të të dhënave për taksapaguesin dhe për mbledhjen e taksës, që të mundësojë bashkitë dhe komunat në përgatitjen dhe në menaxhimin e buxheteve.

Neni 9
Pagesa

1. Taksa paguhet në dy këste të barabarta. Kësti i parë paguhet në kohën e regjistrimit ose të riregjistrimit. Kësti i dytë paguhet jo më vonë se data 30 shtator, me përjashtim të rasteve kur biznesi ka filluar pas datës 31 mars të atij viti. Në këtë rast kësti i dytë duhet të paguhet jo më vonë se data 31 dhjetor.

2. Nëse taksapaguesi paguan shumën e plotë të detyrimit të taksës në kohën e regjistrimit ose të riregjistrimit, atëherë kjo shumë i zvogëlohet me 10 për qind.

3. Nëse taksapaguesi e përfundon procesin e riregjistrimit dhe pajiset me certifikatën e regjistrimit në organet tatimore përpara ditës së fundit të punës për muajin janar të çdo viti të riregjistrimit, ka të drejtën e një zbritjeje prej 2 për qind të shumës së taksës që duhet paguar. Nëse taksapaguesi e përfundon procesin e riregjistrimit dhe pajiset me certifikatën e regjistrimit në organet tatimore përpara ditës së fundit të punës për muajin shkurt të çdo viti të riregjistrimit, ka të drejtën e një zbritjeje prej 1 për qind të shumës së taksës që duhet paguar.

4. Nëse organi tatimor përgjegjës zbulon se taksapaguesi, në çastin e regjistrimit ose të riregjistrimit, ka deklaruar të dhëna të pasakta dhe se shuma fikse për t'u paguar është më e madhe se shuma e paguar, ai, sipas rastit, duhet të njoftojë taksapaguesin. Taksapaguesi paguan detyrimin e taksës shtesë brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit.

5. Taksa paguhet në mënyrën dhe vendin e përcaktuar në udhëzim.

6. Kur një biznes mbyllet gjatë vitit dhe vlera e detyrimit për taksën e llogaritur, në përputhje me pikën e 5 të nenit 5 të këtij ligji, është më e vogël se taksa e paguar, diferenca i kthehet taksapaguesit brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për mbylljen e biznesit.

Neni 10
Transferimi i taksës

Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji transferohet çdo muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, në buxhetin e bashkisë ose të komunës ku është vendndodhja e biznesit të taksueshëm.

Neni 11
Verifikimi

Taksapaguesi detyrohet të lejojë inspektorët e organit tatimor përgjegjës të hyjnë në mjediset ku ushtrohet biznesi, për qëllime verifikimi të të dhënave të regjistrimit dhe për kontrollin e certifikatës së regjistrimit.

Neni 12
Kundërvajtjet dhe dënimet

1. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje

administrative:

a) Mosregjistrimi ose mosriregjistrimi i vendndodhjes së veprimtarisë ekonomike, siç përcaktohet në nenin 6 të këtij ligji, ose mospagimi i taksës brenda datës së caktuar dënohen me gjobë, të barazvlefshme me 25 për qind të detyrimit për taksën.

b) Paraqitja e të dhënave të pasakta ose të paplota në çastin e regjistrimit ose të riregjistrimit dënohet me gjobë prej 10 000 lekësh. Kjo gjobë paguhet së bashku me detyrimin e taksës shtesë, sipas pikës 4 të nenit 9 të këtij ligji.

c) Mosafishimi ose mosparaqitja e certifikatës së regjistrimit, sipas kërkesës së nenit 7 të këtij ligji, dënohet me gjobë prej 10 000 lekësh.

ç) Në rastet kur taksapaguesi nuk lejon inspektorët e organit tatimor përgjegjës të hyjnë në mjediset e biznesit, ai dënohet me gjobë prej 10 000 lekësh.

2. Gjobat paguhen në favor të bashkisë dhe komunës brenda 15 ditëve nga data kur organi tatimor ka nxjerrë vlerësimin.

3. Nëse taksapaguesi nuk paguan taksën ose gjobën, organi tatimor tërheq certifikatën e regjistrimit dhe mbyll biznesin deri në çastin e kryerjes së pagesës.

Neni 13
Apelimet

1. Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet me shkrim ndaj çdo veprimi zyrtar të organit tatimor përgjegjës për shumën dhe mënyrën në të cilën janë vlerësuar detyrimet e tij të taksave, të kërkojë rimbursime, si dhe të apelojë kundër çdo veprimi (ose mosveprimi) tjetër të organit tatimor ose të punonjësve të tij.

2. Çdo apelim paraqitet në organin tatimor përgjegjës brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për veprimin, që është subjekt apelimi. Forma dhe përmbajtja e apelimit përcaktohen në udhëzim.

3. Organi tatimor përgjegjës nxjerr një vendim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të apelimit. Nëse taksapaguesi nuk është i kënaqur me vendimin e zyrës tatimore, ai mund të apelojë në komisionin e apelimit të tatimeve brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit.

4. Komisioni i apelimit të tatimeve nxjerr vendim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së apelimit. Nëse taksapaguesi nuk është dakord me vendimin e komisionit të apelimit të tatimeve, ai mund t'i drejtohet gjykatës brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit me shkrim të vendimit.

5. Kur shqyrton një apelim tatimor, subjekti apelues ka të njëjtat të drejta me organin tatimor, i cili ka vlerësuar fillimisht detyrimin e taksës.

6. Taksapaguesi ka të drejtë të paraqitet vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve ligjorë të tij në të gjitha apelimet dhe të shpjegojë bazën ku e mbështet apelimin.

7. Një apelim tatimor nuk mund të tërhiqet në rastet kur sillen fakte shtesë, që shuma e detyrimit për taksën e vlerësuar nuk është ajo që duhet.

Neni 14
Shfuqizime

Ligji nr.8313, datë 26.3.1998 "Për tatimin për biznesin e vogël", me ndryshimet përkatëse, shfuqizohet.

Neni 15
Dispozita kalimtare

1. Për vitin fiskal 2003, nivelet e taksave për çdo kategori biznesi janë ato të dhëna sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji, dhe këshillat e bashkive dhe të komunave nuk e ushtrojnë të drejtën për t'i ndryshuar ato gjatë vitit fiskal 2003, sipas pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji.

2. Për të gjitha çështjet për të cilat subjektet apelojnë, procedurat e apelimit janë sipas ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore", me ndryshimet përkatëse, për aq kohë sa kjo taksë vazhdon të mblidhet nga administrata qendrore e tatimeve, sipas nenit 4 të këtij ligji.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3611, datë 20.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

TABELA NR.1
NIVELET TREGUESE TË TAKSAVE VENDORE PËR BIZNESIN E VOGËL, SIPAS KATEGORIVE (NË MIJË LEKË NË VIT)

Nr.	TIPI I BIZNESIT	Kat. I	Kat. II	Kat. III
A	Shitje me pakicë	60	20	15
B	Shitje me shumicë	60	20	15
C	Prodhim	35	15	10
Ç	Shërbime	20	10	10
D	Profesione të lira	45	30	15
DH	Ambulant në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve	15	10	10
E	Transport:			
1.	Transport pasagjerësh:			
	Automjete deri në 5 vende (përfshi shoferin)	35		
	Automjete me 6 deri në 9 vende (përfshi shoferin)	70		
	Automjete me 10 deri në 25 vende (përfshi shoferin)	80		
	Automjete me 26 deri në 42 vende (përfshi shoferin)	90		
	Automjete me mbi 42 vende (përfshi shoferin)	95		
2.	Transport mallrash:			
	Automjete deri në 2 tonë	55		
	Automjete nga 2,1 deri në 5 tonë	80		
	Automjete nga në 5,1 deri në 10 tonë	95		
	Automjete nga në 10,1 deri 16 tonë	100		
	Automjete mbi 16 tonë	150		
3.	Transport ujor			
	Transport detar brenda vendit	110		
	Transport në liqene brenda vendit	95		
	Varka për shëtitje	30		

Klasifikimi:
Në kategorinë I: Bashkia e Tiranës, Bashkia e Durrësit.
Në kategorinë II: Bashkitë: Shkodër, Korçë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, Elbasan, Fier, Lushnjë, Pogradec, Berat, Lezhë dhe Kavajë.
Në kategorinë III: Të gjitha bashkitë e tjera.
Në komuna niveli tregues i taksës është 50 për qind e nivelit tregues të tij për çdo kategori.

L I G J
Nr. 8979, datë 12.12.2002

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998 "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT", ME NDRYSHIMET PËRKATËSE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 155 dhe 157 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshimet përkatëse, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 2 "Përkufizime" shtohen paragrafët e mëposhtëm me këtë përmbajtje:

“3) Për qëllimet e Kapitullit III A të këtij ligji:

a) "biznes" nënkupton çdo veprimtari ekonomike që ka për qëllim realizimin e një fitimi;

b) "vendndodhje e biznesit" nënkupton çdo dyqan, njësi të veçantë ose vende të tjera të palëvizshme, ku kryhet biznes;

c) "qarkullim" nënkupton të ardhurat gjithsej të realizuara nga shitja e mallrave dhe kryerja e shërbimeve;

ç) "ambulant" nënkupton një person fizik, të angazhuar në shitjen e mallrave ose kryerjen e shërbimeve, i cili nuk ka vendndodhje fikse të biznesit të tij;

d) "transport individual" nënkupton:

i. një person fizik, që kryen si biznes transportin e mallrave ose të pasagjerëve, duke përdorur jo më shumë se një automjet;

ii. një person fizik, që kryen si biznes transportin e mallrave ose të pasagjerëve në ujërat detare të vendit ose në lumenjtë dhe liqenet brenda vendit, duke përdorur jo më shumë se një mjet lundrues.”
.

Neni 2

Shkronja "a" e pikës 1 të nenit 16 ndryshohet si më poshtë:

“a) Personat juridikë dhe ortakëritë të parashikuara në nënparagrafët "iii" dhe "iv" të shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 2 dhe që janë të regjistruar për TVSH-në.”.

Neni 3

Në fund të nenit 29, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Kontrolli i deklaratës tatimore dhe i bilancit nga ana e administratës tatimore, nuk cenon zbatimin e pikës 3 të këtij neni. Zbulimet që mund të konstatohen nga kontrolli janë objekt i dënimeve dhe sanksioneve që parashikon ky ligj.”.

Neni 4

Pas Kreut III shtohet Kreu III/A me titull "Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin" me këtë përmbajtje
:

"KREU III/A
TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN

Neni 32/1
Fusha e veprimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin

1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin zbatohet ndaj çdo personi, i cili:

a) kryen një biznes në territorin e Republikës së Shqipërisë në çdo kohë, gjatë vitit kalendarik;

b) nuk është i regjistruar ose i detyruar me ligj të regjistrohet për TVSH-në.

2. Përjashtohen nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin:

ambulantët në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve;

ata që kryejnë veprimtari që lidhet me transportin individual.

Neni 32/2

Regjistrimi dhe riregjistrimi

1. Tatimpaguesit detyrohen të regjistrohen në organet tatimore përpara se të fillojnë biznesin. Në çdo vit kalendarik, pas vitit të regjistrimit të parë, tatimpaguesit detyrohen të riregjistrohen përpara datës 31 mars. Në rastet kur tatimpaguesit nuk regjistrohen ose nuk riregjistrohen në kohën e duhur, degët e tatimeve bëjnë regjistrimin e tyre dhe ky regjistrim do të ketë të njëjtat efekte, ashtu si dhe regjistrimi ose riregjistrimi i bërë nga vetë tatimpaguesit.

2. Tatimpaguesit do të regjistrohen ose riregjistrohen në degën e tatimeve të rrethit, ku ndodhet vendi kryesor i veprimtarisë. Mënyra e veprimeve për regjistrim ose riregjistrim përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Gjatë regjistrimit ose riregjistrimit tatimpaguesit duhet të paraqesin të dhënat e mëposhtme:

Për regjistrimin:

i) certifikatë personale me fotografi;

ii) dokumentin e regjistrimit në gjykatë;

iii) llojin ose llojet e bizneseve që do të kryejë;

iv) adresën e vendndodhjes ose të vendndodhjeve të kryerjes së biznesit;

v) deklaratën për qarkullimin e parashikuar për vitin e regjistrimit .

Për riregjistrimin:

i) deklaratën e qarkullimit, sipas kërkesës së pikës 1 të nenit 32/4;

ii) dokumentin që tregon se detyrimi tatimor për vitin e kaluar është paguar plotësisht.

4. Ministri i Financave përcakton me udhëzim mënyrën, metodën dhe çdo të dhënë ose dokument tjetër për regjistrim dhe riregjistrim. Kur tatimpaguesi ka plotësuar kërkesat e regjistrimit, dega e tatimeve e pajis me certifikatë regjistrimi brenda 3 ditëve pune nga çasti i plotësimit të këtyre kërkesave. Formati i kësaj certifikate regjistrimi përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

5. Çdo person i regjistruar pajiset nga dega e tatimeve me një certifikatë regjistrimi. Kur tatimpaguesi e kryen biznesin e vet në dy ose më shumë vendndodhje, ai pajiset me një kopje origjinale të certifikatës së regjistrimit për çdo vendndodhje, me numër të ndryshëm serie.

6. Tatimpaguesi është i detyruar të afishojë certifikatën e regjistrimit në çdo vendndodhje të biznesit.

7. Tatimpaguesi njofton me shkrim degën e tatimeve për çdo ndryshim për të dhënat e paraqitura gjatë regjistrimit ose riregjistrimit. Ministri i Financave përcakton me udhëzim afatin kohor, brenda të cilit paraqiten ndryshimet e kryera.

Neni 32/3

Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është në masën 4 për qind të qarkullimit të realizuar gjithsej nga tatimpaguesi gjatë një viti kalendarik.

Neni 32/4

Deklarimi

1. Tatimpaguesi depoziton një deklaratë me shkrim për qarkullimin e tij gjatë vitit kalendarik jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës. Forma e deklaratës përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.

2. Nëse tatimpaguesi e ndërpret veprimtarinë e vet ekonomike gjatë vitit, ose nuk është më objekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, siç përcaktohet në nenin 32/1, ai detyrohet të paraqesë një deklaratë për vëllimin e qarkullimit gjatë vitit në vazhdim deri në datën e ndërprerjes, brenda 15 ditësh nga ndërprerja.

Neni 32/5

Mbajtja e regjistrimeve

1. Tatimpaguesi detyrohet të mbajë librin e shitjeve (qarkullimit) dhe librin e blerjeve, ku

regjistrohen çdo ditë shitjet dhe blerjet ditore. Librat e mësipërm do të kenë formatin e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave.

2. Tatimpaguesit, shitës me pakicë të mallrave ose shërbimeve, të pajisur me arkë regjistruese, lëshojnë kupon tatimor për çdo shitje. Tatimpaguesit e tjerë, shitës me pakicë të mallrave ose shërbimeve, të papajisur me arkë regjistruese, për çdo shitje të kryer lëshojnë dëftesë tatimore. Për shitjet me shumicë, tatimpaguesit lëshojnë faturë të

thjeshtë tatimore. Mënyra e lëshimit të këtyre dokumenteve përcaktohet në udhëzimin e Ministrit të Financave.

3. Me kërkesë të organeve tatimore, tatimpaguesi është i detyruar të paraqesë regjistrimet e veta për kontroll tatimor ose verifikim.

4. Tatimpaguesi detyrohet të lejojë inspektorët tatimorë të hyjnë në mjediset e biznesit për kontroll ose inspektim.

Neni 32/6

Pagesa

1.a) Tatimpaguesi paguan këstet e detyrimit vjetor, në mbështetje të qarkullimit të vlerësuar për vitin kalendarik.

b) Me përjashtim të rasteve të përcaktuara në shkronjën "c" të kësaj pike, llogaritja e qarkullimit të vlerësuar për një vit kalendarik bazohet në qarkullimin faktik të vitit të kaluar, në parashikimet e deklaruara nga vetë tatimpaguesi dhe në vlerësimet e bëra nga dega e tatimeve.

c) Në rastin e subjekteve të regjistruara për herë të parë, qarkullimi i vlerësuar është qarkullimi i vlerësuar (parashikuar) i tatimpaguesit për periudhën nga data e regjistrimit deri në fund të vitit të parë kalendarik të biznesit të tij. Pas kësaj do të zbatohen dispozitat e shkronjës "b" të kësaj pike.

2. Tatimpaguesi do të paguajë tatimin në dy këste si më poshtë:

a) Në rastin e një tatimpaguesi të riregjistruar:

i. 25 për qind e detyrimit tatimor mbi qarkullimin e vlerësuar, të llogaritur sipas pikës 1 të këtij neni, paguhet brenda datës 31 mars.

ii. 50 për qind e detyrimit tatimor mbi qarkullimin e vlerësuar, të llogaritur sipas pikës 1 të këtij neni, paguhet jo më vonë se data 30 shtator.

b) Në rastin e një tatimpaguesi të regjistruar për herë të parë:

i. 25 për qind e detyrimit tatimor mbi qarkullimin e vlerësuar, të llogaritur sipas pikës 1 të këtij neni, paguhet brenda tre muajve nga data e regjistrimit ose deri më 31 dhjetor, cilado qoftë më e hershmja;

ii. 50 për qind e detyrimit tatimor mbi qarkullimin e vlerësuar, të llogaritur sipas pikës 1 të këtij neni, paguhet brenda nëntë muajve nga data e regjistrimit ose deri më 31dhjetor, cilado qoftë më e hershmja.

3. Me dorëzimin e deklaratës për vitin kalendarik, tatimpaguesi paguan diferencën pozitive ndërmjet detyrimit tatimor dhe parapagesave të bëra. Në rastet e një diference negative, ndërmjet detyrimit tatimor dhe parapagesave të bëra, kjo diferencë përdoret për të shlyer pjesë të parapagesave për vitin e ardhshëm.

4. Kur një inspektor tatimor zbulon se tatimpaguesi nuk ka dorëzuar deklaratën ose nuk ka deklaruar shumën e plotë të qarkullimit, ai do të bëjë një njoftim vlerësimi, ku jepet detyrimi tatimor shtesë. Detyrimi tatimor, në përputhje me njoftimin e vlerësimit, do të paguhet brenda 15 ditëve.

5. Kur një tatimpagues dorëzon një deklaratë për ndërprerjen e biznesit, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 32/4, shuma e plotë e diferencës pozitive ndërmjet detyrimit tatimor dhe pagesave të bëra deri në atë datë, do të paguhet brenda 15 ditëve nga data e ndërprerjes. Kur kemi të bëjmë me një diferencë negative ndërmjet detyrimit tatimor dhe pagesave të bëra, dega e tatimeve do ta rimbursojë këtë diferencë brenda 30 ditëve nga data e marrjes së deklaratës.

6. Tatimi do të paguhet dhe rimbursohet sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave.

7. Tatimi i mbledhur derdhet në Buxhetin e Shtetit dhe transferohet në buxhetin e bashkisë ose komunës ku tatimpaguesi është i regjistruar ose ka vendndodhjen e biznesit. Procedura për derdhjen dhe për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet organeve tatimore qendrore dhe bashkive ose komunave mbi shumën e mbledhur të tatimit, si dhe të dhënat për tatimpaguesit përcaktohen në udhëzimin e

përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

8. Nëse tatimpaguesi e përfundon procesin e riregjistrimit dhe pajiset me certifikatë tatimore përpara ditës së fundit të punës për muajin janar të çdo viti të riregjistrimit, ka të drejtën e një zbritjeje prej 2 për qind të shumës së tatimit për t'u paguar, sipas nenit 32/3 të këtij ligji;

8. a) nëse tatimpaguesi e përfundon procesin e riregjistrimit dhe pajiset me certifikatë tatimore përpara ditës së fundit të punës të muajit shkurt të çdo viti të riregjistrimit, ka të drejtën e një zbritjeje prej 1 për qind të shumës së tatimit për t'u paguar, sipas nenit 32/3 të këtij ligji.

Neni 32/7

Të dhënat

1. Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit u dërgojnë bashkive dhe komunave planin e të ardhurave për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin brenda datës 15 dhjetor të vitit paraardhës.

2. Organi tatimor njofton bashkinë ose komunën jo më rrallë se një herë në gjashtë muaj për punën e bërë për regjistrimin e tatimpaguesve të biznesit të vogël, për nivelin e vjeljes së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe masat e marra për mënjanimin e kundërvajtjeve administrative dhe vjeljen e gjobave.

3. Bashkia dhe komuna, kur e gjykojnë të nevojshme, i kërkojnë organit tatimor kryerjen e veprimeve për regjistrimin e bizneseve, që rezultojnë të paregjistruara, plotësimin e detyrave për administrimin e tatimit dhe derdhjen në favor të saj, sipas afatit ligjor të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin.

Neni 32/8

Kundërvajtjet dhe gjobat

1. Në kuptim të këtij ligji, kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) kur tatimpaguesi nuk regjistrohet ose nuk riregjistrohet, në përputhje me nenin 32/2, ai dënohet me një gjobë prej 50 000 lekësh;

b) kur tatimpaguesi dorëzon një deklaratë të pasaktë, ai dënohet me një gjobë të barazvlefshme me 25 për qind të diferencës ndërmjet tatimit të deklaruar dhe detyrimit tatimor;

c) kur tatimpaguesi nuk paguan tatimin brenda datës së duhur, ai dënohet me gjobë të barazvlefshme me 25 për qind të detyrimit tatimor;

ç) kur tatimpaguesi nuk afishon certifikatën e regjistrimit, në përputhje me pikën 5 të nenit 32/2, ai dënohet me gjobë prej 10 000 lekësh;

d) Kur tatimpaguesi nuk përmbush ndonjërën nga kërkesat e nenit 32/5, ai dënohet me gjobë prej 10 000 lekësh.

2. Në të gjitha rastet gjobat paguhen së bashku me shumën e plotë të detyrimit tatimor, brenda 15 ditëve nga data kur dega e tatimeve nxjerr njoftimin e kundërvajtjes.

3. Gjobat do të paguhen në mënyrën e përcaktuar për pagesën e këtij tatimi.

4. Nëse pas kalimit të afatit 15-ditor, të përcaktuar në përputhje me pikën 2 të këtij neni, tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor dhe gjobën përkatëse, dega e tatimeve vendos mbylljen e veprimtarisë deri në pagimin e plotë të detyrimeve dhe të gjobave.

5. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 5

Dispozita kalimtare

Ministri i Financave dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit përcaktojnë me udhëzim të përbashkët mënyrën e programimit dhe të realizimit të të ardhurave nga ky tatim për vitin 2003.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3612, datë 20.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 8980, datë 12.12.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8560, DATË 22.12.1999
"PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Fjalët "biznes i vogël" kudo ku ato përdoren në ligjin nr.8560, datë 22.12.1999, zëvendësohen me fjalët "taksa vendore për biznesin e vogël".

Neni 2

Në nenin 33 pika 3 ndryshohet si më poshtë:
"3. Në rastet kur ligjet tatimore nuk kërkojnë pagimin e detyrimeve nëpërmjet deklarimit dhe në rastet kur administrata tatimore bazuar në fakte çmon se vlerësimi tatimor i bërë më parë nuk ka qenë i saktë, ajo mund të bëjë një vlerësim të ri, ku të argumentojë shkaqet e rivlerësimit me përllogaritjet përkatëse dhe ta dërgojë njoftim-vlerësimin tek tatim paguesi sipas pikës 1 të këtij neni. Në rastin e rivlerësimit në rritje të detyrimit tatimor, tatimpaguesit i lihet një afat sa dyfishi i afatit normal për pagimin e shtesës së detyrimit. Administrata tatimore, në kuptimin e kësaj pike të këtij neni, mund të bëjë një vlerësim ose të ndryshojë një vlerësim të bërë më parë derisa periudha kufizuese e përcaktuar në nenin 35 të këtij ligji nuk ka mbaruar.".

Neni 3

Pas nenit 41 shtohet neni 42 me këtë përmbajtje:

"Neni 42
Radha e pagesës së detyrimeve tatimore

Pagesa e detyrimeve tatimore në Buxhetin e Shtetit bëhet sipas radhës së mëposhtme:
a) detyrimi tatimor;
b) interesat;
c) dënimet administrative.".

Neni 4

Neni 44 i ligjit ndryshohet si më poshtë:

"Neni 44

1. Nëse detyrimet tatimore nuk janë paguar në kohën e duhur, siç përcaktohet në ligjet e veçanta tatimore, tatimpaguesit janë të detyruar të paguajnë interesa mbi shumën e tatimit të papaguar nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme deri në datën në të cilën pagesa kryhet.

Interesi për mospagim në kohë të detyrimit tatimor është 2 për qind për muajin e parë të vonesës dhe 1,3 për qind për çdo muaj tjetër. Interesi minimal i zbatuar nuk mund të jetë më i vogël se 5 për qind. Përjashtohen nga pagimi i interesave për pagesë të vonuar tatimpaguesit, që i nënshtrohen ligjit për taksën vendore për biznesin e vogël dhe tatimpaguesit, që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin e thjeshtuar, sipas ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat".

2. Interesat zbatohen automatikisht dhe nuk hiqen nga asnjë autoritet.".

Neni 5

Në nenin 46 të ligjit bëhen këto ndryshime:

Në shkronjën "a" të këtij neni shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Kryetari i degës së tatimeve ka të drejtë të nxjerrë një vendim të veçantë ekzekutiv për mbylljen e mjediseve, ku ushtron veprimtarinë e tij ekonomike tatimpaguesi, për aq kohë sa ky i fundit të ketë shlyer detyrimin e tij të papaguar. Këshilli i Ministrave përcakton rastet dhe procedurat, kur kryetari i degës së tatimeve merr një vendim të tillë.".

Shkronja "c" e këtij neni ndryshohet si më poshtë:

"c) Nëse tatimpaguesi nuk mund të paguajë, organi tatimor kërkon fillimin e procedurave të falimentimit si kreditor i interesuar, në mbështetje të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin".".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3613, datë 20.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 8981, datë 12.12.2002

PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Miratimin e niveleve të tarifës doganore, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ligji nr.8474, datë 14.4.1999 “Për miratimin e nomenklaturës dhe të tarifës doganore” dhe të gjitha dispozitat e tjera, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3614, datë 20.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

L I G J
Nr. 8982, datë 12.12.2002

PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1, 113 pika 1 shkronja “ç”, 155 dhe 157 pika 3 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji janë taksat e bashkive dhe komunave.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Ky ligj përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore dhe mbledhjen e administrimin e tyre.

Neni 3
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Tokë bujqësore” nënkupton tokën e përcaktuar sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurisë.

2. Termat e përcaktuar në nenin 2 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, që përdoren në këtë ligj, kanë të njëjtat kuptime.

Neni 4
Zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë

1. Bashkitë dhe komunat, si dhe organet tatimore i ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre tatimore, të përcaktuara në këtë ligj, në përputhje me ligjin nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore” dhe me çdo akt tjetër detyrues, që bën pjesë në sistemin tatimor të Republikës së Shqipërisë.

2. Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve.

Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri bëhen sipas udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin "Për procedurat tatimore".

3. Këshilli i bashkisë dhe këshilli i komunës miratojnë procedura më të hollësishme për taksat e bashkisë ose komunës, në përputhje me procedurat e miratuara me ligj.

Neni 5
Rregulla të përbashkëta për taksat e bashkisë dhe të komunës

Këshilli i bashkisë ose këshilli i komunës zbaton për taksat e përcaktuara në këtë ligj, me përjashtim të rasteve kur në ligj përcaktohet ndryshe, këto rregulla të përbashkëta:

1. Vendos numrin e kësteve të pagimit të taksës nga taksapaguesi, kohën e kryerjes së tyre dhe kushtet lehtësuese, në rastet e pagesës së plotë e para afateve të detyrimeve nga taksapaguesit.

2. Vendos nëse mbledhja e një takse vendore do të kryhet nga strukturat e njësisë së qeverisjes vendore ose agjentët e taksave, jashtë këtyre strukturave.

Neni 6
Përjashtimi nga taksat

Përjashtohen nga taksat vendore të gjitha subjektet e parashikuara shprehimisht në këtë ligj dhe me ligje të veçanta.

Neni 7
Ankimi

Ankimi i taksapaguesit në nivel vendor bëhet te kryetari i bashkisë ose komunës, sipas kritereve dhe rregullave të vendosura nga këshilli bashkiak ose komunal, në përputhje me nenin 4 të këtij ligji. Taksapaguesi ka të drejtë të ankohet në gjykatë kundër vendimit të kryetarit të bashkisë ose komunës.

KREU II
TAKSAT VENDORE

Neni 8
Llojet e taksave vendore

Në taksat vendore përfshihen:

a) taksa vendore mbi biznesin e vogël, e cila rregullohet me ligj të veçantë;

b) taksa mbi pasuritë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore;

c) taksa e fjetjes në hotel;

ç) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;

d) taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;

dh) taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve;

e) taksa për zënien e hapësirave publike;

ë) taksa e tabelës;

f) taksa të përkohshme.

KREU III
TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME

Neni 9
Përcaktimi dhe llojet

1. Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë,

vendas ose të huaj, që janë pronarë të pasurive të mësipërme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të tyre. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron.

2. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

taksa mbi ndërtesat;

taksa mbi tokën bujqësore.

Neni 10

Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme

1. Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Periudha e detyrimit vjetor të taksave fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të vitit në vazhdim. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

2. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën dhe për taksën mbi tokën bujqësore jepen përkatësisht në anekset 1 dhe 2, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij ligji.

3. Këshilli bashkiak ose këshilli komunal vendos për nivelin e taksës që do të zbatojë për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në anekset 1 dhe 2, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

4. Kur për një kategori minimale të bazës së taksës, këshilli bashkiak ose këshilli komunal miraton nënkategori, ai detyrimisht përcakton edhe nivelin e taksës për secilën nënkategori. Niveli i taksës për çdo nënkategori është brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Këshilli bashkiak ose këshilli komunal vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:

a) personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kritereve të përcaktuara në nivel kombëtar;

b) taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak ose këshilli komunal, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.

Neni 11

Taksa mbi ndërtesat

1. Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi. Kategoritë minimale të ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin 1 të këtij ligji. Për çdo kategori minimale të ndërtesave, këshilli bashkiak ose këshilli komunal mund të miratojë nënkategorizime të ndërtesave, që ndodhen brenda territorit që mbulon.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e taksueshme.

3. Të ardhurat e realizuara nga taksa mbi ndërtesat i takojnë 100 për qind bashkisë ose komunës, ku realizohet kjo taksë.

4. Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën:

a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;

b) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;

c) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare.

Neni 12

Taksa mbi tokën bujqësore

1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 2 të këtij ligji. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak ose këshilli komunal mund të miratojë nënkategorizime të tyre.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2 të këtij ligji.

3. Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga momenti i mbjelljes.

Neni 13

Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të komunës njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna pa kundërshpërblim bashkive dhe komunave, për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe komunat për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të komunës, për vërtetim pronësie njohin tapinë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me ligjin.

Neni 14

Pronat që shtrihen në territorin e më shumë se një njësie të qeverisjes vendore

Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose komune, pavarësisht vendbanimit të pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.

Neni 15

Taksa e fjetjes në hotel

1. Për qëllim të këtij ligji, me hotel do të kuptohet çdo veprimtari që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizmi familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këto qëllime.

2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është çmimi i fjetjes, sipas rastit, për dhomë ose për person, për një natë.

3. Niveli i taksës është deri në 5 për qind të çmimit të fjetjes.

4. Këshilli bashkiak ose këshilli komunal mund të miratojë kategori dhe nënkategori për klasifikimin e hoteleve, si dhe të vendosë për nivelin përkatës të taksës, brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia ose komuna me çmimin e fjetjes dhe numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

6. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë ose të komunës, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

7. Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Neni 16

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri, që kërkohet të kryhet. Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat përkatëse përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1 deri në 3 për qind të kësaj vlere investimi, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 deri 4 për qind të kësaj vlere investimi.

3. Këshilli bashkiak ose këshilli komunal mund të miratojë kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.

4. Detyrimi për taksën i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë ose të komunës, ku përfshihet territori në të cilin do të bëhet investimi.

5. Nëse objekti për të cilin do të bëhet investimi shtrihet në territorin e më shumë se një njësie vendore ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një njësie tjetër vendore, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës njësi.

Neni 17

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

1. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme, në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

2. Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave, për efekt të bazës së taksueshme, jepen në aneksin nr.3 të këtij ligji. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

3. Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

4. Vjelja e kësaj takse bëhet nga zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të cilat, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë ose të komunës, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e çdo muaji.

Neni 18

Përjashtime nga pagimi i taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

1. Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a) Enti Kombëtar i Banesave, Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;

b) personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”;

c) subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:

i. institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;

ii. bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak ose këshilli komunal për përjashtimin nga taksa. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

2. Për rastet kur pranohet nga vetë palët ose vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohet taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjit.

Neni 19

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor

1. Baza e taksës është lloji i mjetit të transportit rrugor.

2. Niveli i taksës shprehet në një kuotë të caktuar, sipas llojit të mjetit. Kategoritë dhe nivelet e caktuara sipas mjeteve përcaktohen në aneksin nr.4, pjesë përbërëse e këtij ligji.

3. Detyrimi për taksën i takon pronarit të mjetit.

4. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor në çastin e regjistrimit dhe kontrollohet nga Drejtoria e Qarkullimit Rrugor. Taksa derdhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për llogari të bashkisë ose të komunës, sipas vendbanimit ose selisë së pronarit, deri në datën 5 të muajit pasardhës.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Qarkullimit Rrugor, në rolin e agjentit të taksave, përfitojnë përkatësisht 10 për qind dhe 2 për qind të shumës së arkëtuar.

6. Afati i fundit i regjistrimit të mjetit dhe i shlyerjes së detyrimit vjetor nga taksapaguesi është data 31 mars. Pas kësaj date Policia e Qarkullimit Rrugor, kur konstaton se nuk është paguar kjo taksë, zbaton një gjobë të barabartë me taksën dhe nëse taksa dhe gjoba nuk paguhen brenda 10 ditëve, ajo bllokon mjetin deri në pagesën e taksës dhe të gjobës. Të ardhurat nga gjobat mblidhen sipas mënyrës së mbledhjes së taksës të regjistrimit të përvitshëm të mjeteve dhe ato ndahen 50 për qind në favor të Policisë së Qarkullimit Rrugor dhe 50 për qind në favor të bashkisë ose komunës, sipas vendbanimit ose selisë së pronarit të mjetit.

7. Për mjetet që regjistrohen për herë të parë, taksa paguhet e plotë për regjistrim gjatë 6-mujorit të parë dhe gjysma e saj për regjistrim gjatë 6-mujorit të dytë të vitit.

Neni 20

Përjashtimi nga pagimi i taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor

Përjashtohen nga pagimi i taksës për regjistrimin e përvitshëm mjetet në pronësi të trupave diplomatikë dhe të organizatave ndërkombëtare të akreditуara në Republikën e Shqipërisë, që gëzojnë statusin diplomatik, duke zbatuar parimin e reciprocitetit.

Neni 21

Taksa të tjera

Këshilli bashkiak ose këshilli komunal vendosin bazën dhe nivelin për:
taksën për zënien e hapësirave publike;
taksën e tabelës.

Neni 22

Taksat vendore të përkohshme

Këshilli bashkiak ose këshilli komunal, kur e gjykon të domosdoshme, mund të vendosë taksa me karakter të përkohshëm, në interes të përgjithshëm të banorëve të territorit në juridiksionin e vet.

KREU IV
TARIFAT VENDORE DHE ADMINISTRIMI I TYRE

Neni 23

Tarifat vendore dhe administrimi i tyre

1. Çdo pagesë tjetër në favor të bashkisë, të komunës ose të qarkut klasifikohet si tarifë kur:

a) përkon me përcaktimet e paragrafit të tretë të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;

b) nuk është taksë bashkiake ose komunale, si dhe gjobë e lidhur me to, sipas këtij ligji.

2. Tarifat vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe në këtë ligj ose në ligje të tjera, që rregullojnë funksionet dhe tarifat e lidhura me to, këshilli bashkiak dhe ai komunal vendosin për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin e mbledhjen e

tyre, përcaktojnë nëse tarifat mblidhen nga vetë strukturat bashkiake dhe komunale ose nga një agjent. Në rastin e agjentit këshilli vendor për rregullat bazë e kufizuese në raport me të dhe kryetari i bashkisë ose i komunës bën përzgjedhjen e agjentit dhe lidh kontratën me këtë të fundit.

KREU V
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24
Fillimi i ushtrimit të kompetencave

Ushtrimi i kompetencave të dhëna bashkive, komunave dhe qarqeve nga ky ligj për taksat bashkiake dhe komunale, si dhe për tarifat vendore fillon ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 25
Nxjerrja e akteve për zbatimin e ligjit

Ministri i Financave dhe Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nxjerrin aktet e nevojshme për zbatimin e këtij ligji, në përputhje me përgjegjësitë e dhëna, sipas neneve 8 e 9 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore”.

Neni 26
Shfuqizime

Për efekt të zbatimit të këtij ligji, shfuqizohen:

1. Ligji nr.7805, datë 16.3.1994 “Për tatimin mbi pasurinë”.
2. Paragrafi i dytë i nenit 51 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar me ligjin nr.8501, datë 16.6.1999.
3. Të gjitha dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore, për aq sa bie në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 27
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3615, datë 20.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu

ANEKSI 1
NIVELET TREGUESE TË TAKSËS MBI NDËRTESAT

Bashkitë			
	Zona 1	Zona 2	Zona 3
Kategoritë minimale të ndërtesave	Tiranë Durrës	Vlorë Fier Sarandë Pogradec Korçë Elbasan Berat Lushnjë Gjirokastër Shkodër Kavajë Lezhë	Të gjitha bashkitë e tjera
Lekë/m2 në vit			
I. Ndërtesa banimi			
ndërtuar para 1993-shit	15	10	5

- ndërtuar gjatë dhe pas 1993-shit	30	12	6
II. Ndërtesa të tjera			
- për tregti dhe shërbime	200	150	100
- të tjera	50	30	20

Shënim I: Nivelet treguese të taksës, dhënë në tabelë, janë të vlefshme për ndërtesat në zonat urbane (bashkitë).

Shënim II: Në zonat rurale (komunat), niveli tregues i taksës për çdo kategori minimale të ndërtesës është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës në bashkitë qendër rrethi, në të cilat ndodhet komuna.

ANEKSI 2

KATEGORITË MINIMALE DHE NIVELET TREGUESE TË TAKSËS MBI TOKËN BUJQËSORE

	Klasifikimi sipas rretheve		
1	2	3	4
Tiranë	Shkodër	Gjirokastër	Bulqizë
Durrës	Elbasan	Përmet	Has
Kavajë	Berat	Pogradec	Kukës
Krujë	Korçë	Librazhd	Tropojë
Lezhë	Delvinë	Dibër	Pukë
Lushnjë	Kurbin	Mat	Mirditë
Fier	Peqin	Skrapar	Malësi
Vlorë	Kuçovë	Mallakastër	e Madhe
Sarandë		Devoll	Gramsh
		Tepelenë	Ersekë

VLERA E TAKSËS NË LEKË/HEKTAR/VIT

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës				
I	5 600	4 200	2 800	1 400
II	4 900	3 500	2 100	1 200
III	4 200	2 800	1 400	1 100
IV	3 600	2 300	1 350	1 000
V	3 000	1 900	1 250	900
VI	2 400	1 600	1 200	800
VII-X	1 800	1 400	1 100	700

Shënim: Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

ANEKSI 3

NIVELET E TAKSËS SË KALIMIT TË PRONËSISË MBI NDËRTESAT

Bashkitë			
	Zona 1	Zona 2	Zona 3
Kategoritë e ndërtesave	Tiranë Durrës	Vlorë Fier Sarandë Pogradec Korçë Elbasan Berat Lushnjë Gjirokastër Shkodër Kavajë Lezhë	Të gjitha bashkitë e tjera

Lekë/m2			
I. Ndërtesa banimi	1 000	300	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	2 000	700	300
II. Ndërtesa të tjera	1 500	500	200

Shënim I: Nivelet treguese të taksës, dhënë në tabelë, janë të vlefshme për bashkitë.
Shënim II: Të gjitha komunat zbatojnë nivelin e taksës për zonën 3 të bashkive.

ANEKSI 4

TAKSAT VJETORE PËR REGJISTRIMIN E PËRVITSHËM TË MJETEVE

Nr.	Tipi i mjetit	Masa e Taksës në lekë
1.	Motomjete	600
2.	Autoveturë me më pak ose e barabartë me) 4 + 1) vende	2 400
3.	Autoveturë dhe mikrobus me më shumë se (4 +1(dhe me më pak ose e barabartë me (8 +1) vende	4 800
4.	Autobus me më pak ose i barabartë me (32 + 1) vende	6 000
5.	Autobus me më pak ose i barabartë me (42 + 1) vende	7 200
6.	Autobus me më shumë se (42 + 1) vende	8 400
7.	Autobus artikular me më shumë se (42 + 1) vende	9 000
8.	Furgon dhe kamion me peshë maksimale të autorizuar deri në 3,5 tonë	3 600
9.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 3,5 deri ose të Barabartë me 7,5 tonë	4 800
10.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 deri ose të Barabartë me 18 tonë	6 000
11.	Kamion me peshë maksimale të autorizuar mbi 18 tonë	8 000
12.	Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, karkalec etj. (me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të barabartë me 7,5 tonë	3 000
13.	Mjete për punime ndërtimi dhe toke (traktor rrugor, fadromë, Autovinç etj.) me peshë maksimale të autorizuar mbi 7,5 tonë	3 600
14.	Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar më të vogël ose të Barabartë me 7 tonë	3 000
15.	Rimorkio me peshë maksimale të autorizuar mbi 7 tonë	4 000

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);



U dorëzua për shtyp më 21. 12. 2002
Doli nga shtypi më 21. 12. 2002

Tirazhi: 4250 copë Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë